



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: Operatorin ekonomik „Infratech“ sh.p.k

Adresa: Tiranë, Rruga Besim Imami, pallati 12 katësh, kati i 2-te, nr.13.

Procedura e prokurimit: **Mbikëqyrja e Punimeve të Ndërtimeve dhe Rikostruksioneve të Rrjetit Ujësjiellës Kanalizime për UKT sh.a(faza e 1)**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-58109-05-14-2020, loti 4 REF-58121-05-14-2020.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Mbikëqyrja e Punimeve të Ndërtimeve dhe Rikostruksioneve të Rrjetit Ujësjiellës Kanalizime për UKT sh.a(faza e 1), Mbikqyrja e punimeve për objektin: Ndërtim rrjet kanalizimi në Rrugën "Kastriotet", Tiranë”

Fondi limit: 11,875,114,20(njëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e katërbëdhjetë presje njëzetë)lekë pa tvsh.

Fondi limit, loti 4: 116,979(njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë)lekë pa tvsh

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin loti 4: 20 ditë duke nisur nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 08.06.2020 Ora: 11:00

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Instituti Dekliada- Alb” sh.p.k

K71606006A

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 106,450,89(njëqind e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë presje tetëdhjetë e nëntë)lekë pa tvsh.

2. “Unitec Studio” sh.p.k

K72316010C

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 106 568.94(njëqind e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë presje nëntëdhjetë e katër)lekë pa tvsh.

3. “SRP Albanian Enginering” sh.p.k

L81728013G

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 107,231(njëqind e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e një)lekë pa tvsh.

4.BO”Nord Comad” sh.p.k

&

“Argi” sh.p.k

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

L08501501Q

&

K62028003A

Vlera 107, 980.73(njëqind e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë presje shtatëdhjetë e tre)lekë pa tvsh.

5. Infratech sh.p.k

K91628001D

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 107,980,8(njëqind e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë presje tetë)lekë pa tvsh.

6. “Derbi-E” sh.p.k

K77916947A

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 108,000(njëqind e tetë mijë)lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Instituti Dekliada- Alb” sh.p.k

K71606006A

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 106,450,89(njëqind e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë presje tetëdhjetë e nëntë)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë vijon:
Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjate shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur

elektronikisht nga Operatori Ekonomik “ Instituti Dekliada-Alb sh.p.k konstatoi se, Operatori Ekonomik “Instituti Dekliada-Alb sh.p.k nuk plotëson, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik, pasi Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur nga Operatori Ekonomik është nën vlerën minimale të përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Kandidati ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Operatori ekonomik do të skualifikohet nëse ofertat e tyre do të rezultojnë nën minimumin e lejuar të përlogaritur nga AK (në bazë të VKM nr.354, datë 11.05.2016 si dhe njoftimit të APP-së nr.5585, datë 27.07.2017).

Oferta e Operatorit Ekonomik “ Instituti Dekliada-Alb ” sh.p.k, rezulton nën minimumin e lejuar të përlogaritur nga Autoriteti Kontraktor, në bazë të VKM nr.354, datë 11.05.2016.

Bazuar në Rekomandimin e APP-së nr.5585 datë 25.07.2017 “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim”, pika 2 shprehimisht thuhet se :

“Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim, tarifat mund të jenë më të ulta sesa normat minimale, të specifikuara nga ky manual”

Në rastin kur Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar rrethanën e jashtëzakonshme, Autoriteti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertës duhet ti referohet vlerësimit minimal të përlogaritur për këtë procedurë prokurimi në bazë të parashikimit në VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim”.

Në rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar me shkrim nëse ndodhet në rrethana të jashtëzakonshme për procedurën e prokurimit me objekt” Loti i katërt:

“Mbikëqyrja e punimeve për objektin: Ndërtim rrjet kanalizimi në Rrugën "Kastriotet", Tiranë”

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “ Instituti Dekliada –Alb” sh.p.k, është i paplotë pasi nuk ka përmbushur VKM nr.354 date 11.05.2016 ”Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe udhezimin e Agjencise Prokurimit Publik date 25.07.2017, prot 5585

”Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.354,date 11.05.2016” Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje VKM nr.354 date 11.05.2016 ”Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe udhezimin e Agjencise Prokurimit Publik date 25.07.2017, prot 5585 ”Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.354,date 11.05.2016” Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” , e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e sa më sipër.

2. "Unitec Studio" sh.p.k
Emri i plotë i shoqërisë

K72316010C
numri i NIPT-it

Vlera 106 568.94(njëqind e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë presje nëntëdhjetë e katër)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë vijon:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjate shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur elektronikisht nga Operatori Ekonomik " Unitec Studio sh.p.k konstatoi se, Operatori Ekonomik "Unitec Studio sh.p.k sh.p.k nuk plotëson, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik, pasi Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur nga Operatori Ekonomik është nën vlerën minimale të përlllogaritur nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Operatori ekonomik do të skualifikohet nëse ofertat e tyre do të rezultojnë nën minimumin e lejuar të përlllogaritur nga AK (në bazë të VKM nr.354, datë 11.05.2016 si dhe njoftimit të APP-së nr.5585, datë 27.07.2017).

Oferta e Operatorit Ekonomik "Unitec Studio sh.p.k rezulton nën minimumin e lejuar te përlllogaritur nga Autoriteti Kontraktor, në baze të VKM nr.354, date 11.05.2016.

Bazuar në Rekomandimin e APP-së nr.5585 datë 25.07.2017 "Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në VKM nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim", pika 2 shprehimisht thuhet se :

"Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim, tarifatat mund të jenë më të ulta sesa normat minimale, të specifikuara nga ky manual"

Në rastin kur Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar rrethanën e jashtëzakonshme, Autoriteti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertës duhet ti referohet vlerës minimale të përlllogaritur për këtë procedurë prokurimi në bazë të parashikimit në VKM nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim".

Në rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar me shkrim nëse ndodhet në rrethana të jashtëzakonshme për procedurën e prokurimit me objekt" Loti i katërt:

"Mbikëqyrja e punimeve për objektin: "Ndërtim rrjet kanalizimi në Rrugën "Kastriotet", Tiranë"

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik " Unitec Studio sh.p.k " sh.p.k, është i paplotë pasi nuk ka përmbushur VKM nr.354 date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per shërbime në planifikimin te territorit, projektim, mbikëqyrje dhe

kolaudim” si dhe udhezimin e Agjencise Prokurimit Publik date 25.07.2017, prot 5585 “Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.354,date 11.05.2016” Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave nga shqyrtimi i kesaj oferte ne mbeshetje VKM nr.354 date 11.05.2016 “Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe udhezimin e Agjencise Prokurimit Publik date 25.07.2017, prot 5585 “Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.354,date 11.05.2016” Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” , e shpall te pavlefshme kete oferte pasi nuk ploteson kerkesat e sa me sipër.

Së dyti AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

e.Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Në përmbushje të kriterit të kërkuar operatori ekonomik “ Unitec Studio ”sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik :

“Vërtetim debie” nr. 7530/1,datë 03.04.2020 lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike vertetojm se kërkuesi “ Unitec Studio” sh.p.k nga verifikimet e kryera në sistemin e Faturimit, për kontratën/ kontratat bashkëlidhur; titullari i të cilave Unitec Studio sh.p.k rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 02.04.2020 duke përfshirë faturën koherente të muajit Mars 2020.

Referuar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht muajin Prill 2020.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vleresimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “d” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastiit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

Gjithashtu vlen të theksojmë se publikimi i procedurës objekt në sistemin elektronik të app-së

është bërë në datën 15.05.2020 dhe data e hapjes së ofertave është lënë më datën 08.06.2020 brenda këtij afati operatorët ekonomikë e kishin detyrim të kishin bërë bërë pagesën e faturës së muajit Prill 2020 si dhe të pajiseshin me vërtetim mbi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri kjo theksojmë Refruar Neni 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar. Në mbështetje të VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë”

Në shtojcën 7 shprehimisht parashikohet se ...Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

3. “SRP Albanian Enginering” sh.p.k

L81728013G

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 107,231(njëqind e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e një)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjate shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga Operatori Ekonomik “SRP Albanian Enginering sh.p.k konstatoi se, Operatori Ekonomik “ SRP Albanian Enginering sh.p.k nuk plotëson, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik, pasi Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur nga Operatori Ekonomik është nën vlerën minimale të përllorësit nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Kandidati ofertues në përllorësitjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Operatori ekonomik do të skualifikohet nëse ofertat e tyre do të rezultojnë nën minimumin e lejuar të përllorësit nga AK (në bazë të VKM nr.354, datë 11.05.2016 si dhe njoftimit të APP-së nr.5585, datë 27.07.2017).

Oferta e Operatorit Ekonomik “ SRP Albanian Enginering” sh.p.k rezulton nën minimumin e lejuar të përllorësit nga Autoriteti Kontraktor, në bazë të VKM nr.354, datë 11.05.2016. Bazuar në Rekomandimin e APP-së nr.5585 datë 25.07.2017 “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim”, pika 2

shprehimisht thuhet se :

“Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim, tarifat mund të jenë më të ulta sesa normat minimale, të specifikuar nga ky manual”

Në rastin kur Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar rrethanën e jashtëzakonshme, Autoriteti Kontaktor gjatë vlerësimit të ofertës duhet ti referohet vlerës minimale të përlllogaritur për këtë procedurë prokurimi në bazë të parashikimit në VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim”.

Në rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar me shkrim nëse ndodhet në rrethana të jashtëzakonshme për procedurën e prokurimit me objekt” Loti i katërt:

“Mbikqyrja e punimeve për objektin: Ndërtim rrjet kanalizimi në Rrugën "Kastriotet", Tiranë”

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “SRP Albanian Enginnering” sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur VKM nr.354 date 11.05.2016 *”Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe udhezimin e Agjencise Prokurimit Publik date 25.07.2017, prot 5585 ”Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.354,date 11.05.2016” Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje VKM nr.354 date 11.05.2016 ”Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe udhezimin e Agjencise Prokurimit Publik date 25.07.2017, prot 5585 ”Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.354,date 11.05.2016” Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” , e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e sa më sipër.

4. BO”Nord Comad” sh.p.k & Argi sh.p.k

Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
L08501501Q & K62028003A

107, 980.73(njëqind e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë presje shtatëdhjetë e tre)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga BO”Nord Comad &Argi” sh.p.k konstatoi se BO“Nord Comad &Argi nuk plotëson, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik, pasi Vlera e ofertës ekonomike të paraqitur nga Operatori Ekonomik është nën vlerën minimale të përlllogaritur nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Operatori ekonomik do të skualifikohet nëse ofertat e tyre do të rezultojnë nën minimumin e

lejuar të përlllogaritur nga AK (në bazë të VKM nr.354, datë 11.05.2016 si dhe njoftimit të APP-së nr.5585, datë 27.07.2017).

Oferta e BO“Nord Comad &Argi” rezulton në minimumin e lejuar të përlllogaritur nga Autoriteti Kontraktor, në bazë të VKM nr.354, datë 11.05.2016.

Bazuar në Rekomandimin e APP-së nr.5585 datë 25.07.2017 “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim”, pika 2 shprehimisht thuhet se :

“Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim, tarifat mund të jenë më të ulta sesa normat minimale, të specifikuara nga ky manual”

Në rastin kur Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë nuk kanë dokumentuar rrethanën e jashtëzakonshme, Autoriteti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertës duhet të referohet vlerësimit të përlllogaritur për këtë procedurë prokurimi në bazë të parashikimit në VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim”.

Në rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka dokumentuar me shkrim nëse ndodhet në rrethana të jashtëzakonshme për procedurën e prokurimit me objekt” Loti i katërt:

“Mbikëqyrja e punimeve për objektin: Ndërtim rrjet kanalizimi në Rrugën "Kastriotet", Tiranë”

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga BO“Nord Comad” &Argi” sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur VKM nr.354 date 11.05.2016 ”Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe udhezimin e Agjencise Prokurimit Publik date 25.07.2017, prot 5585 ”Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.354,date 11.05.2016” Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje VKM nr.354 date 11.05.2016 ”Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe udhezimin e Agjencise Prokurimit Publik date 25.07.2017, prot 5585 ”Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.354,date 11.05.2016” Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” , e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e sa më sipër.

Së dyti AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

2.6.Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019.

2.7.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Në përmbushje të kriterit të kërkuar nga AK njëri nga operatorët ekonomikë përkatësisht Nord Comad sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik vërtetim për shlyerjen e taksave vendore datë 20.05.2019, vërtetim për shlyerjen e taksave vendore datë 08.05.2020, lëshuar nga Bashkia Tiranë.

Referuar ekstraktit historik të paraqitur në sistemin elektronik operatori ekonomik Nord Comad sh.p.k rezulton se ky i fundit ushtron aktivitet edhe aktivitet në Fushë Krujë përkatësisht të regjistruar 12/07/2018 me numër çështje : CN-858341-07-18 " Durrës; Krujë; Fushë

Krujë, Rruga e Stafukëve, Ura e Gjoles, Magazina Nr.1, Fushe-Krujë.

Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin elektronik të prokurimeve KVO konstaton se operatori ekonomik Nord Comad sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Fushë- Krujë për vitin 2019.

Përderisa rezulton që operatori ekonomik Nord Comad sh.p.k vazhdon të ushtrojë aktivitet pranë Bashkisë Fushë-Krujë ka qënë i detyruar të paraqesë në sistemin e prokurimeve elektronike vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019 në vendin ku ushtron aktivitetin ashtu siç është kërkuar në DT.

Sqarojmë se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Neni 12 “Rregjistrimi dhe Liçensimi” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se: Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

5. “Derbi-E” sh.p.k

Emri i plotë i shoqërisë

K77916947A

numri i NIPT-it

Vlera 108,000(njëqind e tetë mijë)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e përgjithshme të kualifikimit(shtojca 7) si më poshtë cituar:

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

 _____ etj.
 nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP¹.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
 - Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër

Në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik Derbi-E sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik deklaratën e kriterëve të përgjithshme.

Nga shqyrtimi i deklaratës të kriterëve të përgjithshme KVO konstaton se deklarata e paraqitur nuk është paraqitur dhe nuk është plotësuar në mënyrë të saktë sipas formatit të miratuar nga ana e Agjencisë të Prokurimit Publik me anë të vendimit nr.6 datë 20.06.2019 si dhe DST të publikuar në sistemin elektronik nga ana e AK.

Theksojmë se shtojca 7 kërkon domosdoshmërisht citimin e emrit nën cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, të cilët nuk duhet të jenë ose të kenë qënë të dënuar me vendim të formës së prerë të përcaktuar në nenin 45 të LPP-së.

Akoma më tej citojmë se shtojca e kriterëve të përgjithshme është e qartë dhe nuk lë vend për

konfuzion në përgatitjen e dokumentacionit nga ana e operatorëve ekonomikë.

Përsa cituam më lart shtojca e paraqitur nga operatori ekonomik Derbi-E sh.p.k nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar.

Në shtojcën 12 të DST-së shprehimisht citohet se : Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik Infratech sh.p.k se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 107,980,8(njëqind e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë presje tetë)lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë UKT sh.a, Drejtoria e Prokurimeve sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60(gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 11.06.2020

Ankesa: JO